



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9225 prot.

Roskovec, më 26.11.2024

VENDIM

Nr. 70, datë 25.11.2024

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 109, DATË 21.12.2023 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT, NUMRIT MAKSIMAL TË PUNONJËSVE TË BASHKISË DHE TË NDËRMARJEVE VARTËSE TË BASHKISË PËR VITIN 2024", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 54 shkronja "dh" të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", të ndryshuar; Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Udhëzimit Nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 109, datë 21.12.2023 "Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2024", të ndryshuar, si dhe shkresës së Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Nr. 138, datë 13.11.2024 protokolluar në institucionin tonë me Nr. 8818, datë 13.11.2024, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 109, datë 21.12.2023 "Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2024", të ndryshuar, si më poshtë vijon:
 - Numri maksimal i punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive administrative e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë për vitin 2024 nga **386 (treqind e tetëdhjetë e gjashtë)** punonjës të përhershëm bëhet **393 (treqind e nëntëdhjetë e tre)** punonjës të përhershëm. Konkretisht, shtohen në organikën e Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale **7 (shtatë)** punonjës të përhershëm dhe numri maksimal i punonjësve për Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale ndryshon nga **32 (tridhjetë e dy)** bëhet **39 (tridhjetë e nëntë)** punonjës të përhershëm.
2. Fondi të përballohet nga fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore të miratuar për vitin 2024.
3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, Drejtoria Ekonomike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka